# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-459375**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dy të arrestuar në aksin Kakavijë-Gjirokastër, sekuestrohen 22 mijë euro dhe mallra kontrabandë |
| ADRESA | `https://tpz.al/dy-te-arrestuar-ne-aksin-kakavije-gjirokaster-sekuestrohen-22-mije-euro-dhe-mallra-kontrabande-i333418` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 08:42:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 08:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d90837ac04bea9f2e764830c9cdec833b95dccc5f7ede8b388a677cb536d1882` |
| TEKSTI | `bb9a9a9a91b2afbece4392cddb546f327bf2166b0f58ba12d57ab958047f4d83` |
| PAMJA | `dd1fadc9c84a4d07905114b32a1b3fed508a769406793da53c96cdd0fa2720c1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `95b7a300d4337ad3f7f27d48e73ba266599bdaecb868f286a19bc4bf345e17e9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7843691d73f82da58f46c5c712d0bec6679deb0584938ea073db401557569169` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/95b7a300d4337ad3f7f27d48e73ba266599bdaecb868f286a19bc4bf345e17e9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 20 SEPTEMBER 2026, 10:25

# Dy të arrestuar në aksin Kakavijë-Gjirokastër, sekuestrohen 22 mijë euro dhe mallra kontrabandë

TPZ




Operacioni policor i koduar "Akciza 3" ka finalizuar goditjen e një rasti të dyshuar të kontrabandës së mallrave nga Greqia në Shqipëri. Në pranga kanë rënë dy shtetas, të cilët u kapën në flagrancë në aksin rrugor "Kakavijë-Gjirokastër", duke transportuar me autobus mallra të ndryshme të dyshuara të kontrabanduara.

Të arrestuarit janë O. L., 43 vjeç, dhe M. D., 43 vjeç, të dy banues në Tiranë. Operacioni u zhvillua nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare, pas informacioneve të marra nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore Rajonale Vlorë-Gjirokastër dhe në kuadër të kontrolleve për parandalimin dhe goditjen e kontrabandës së mallrave.

Shërbimet e Policisë ndaluan autobusin në aksin "Kakavijë-Gjirokastër", i cili drejtohej me ndërrim turnesh nga dy të arrestuarit. Gjatë kontrollit, në vende të mbyllura dhe të fshehura të autobusit, u gjetën 100 steka me cigare dhe 22 695 euro, ndërsa në bagazh u zbuluan sasi të ndryshme mallrash.

Sipas Policisë, në autobus u gjetën kuti me produkte deti dhe mishi, produkte bulmeti, kuti me medikamente, si dhe 13 thasë me veshje të markave të ndryshme. Në automjet u konstatuan edhe mallra të tjera, të cilat dyshohet se ishin kontrabanduar nga Greqia për t'u futur në Shqipëri.

Përveç mallrave dhe shumës së parave, në cilësinë e provës materiale u sekuestruan edhe autobusi dhe një aparat celular. Policia dyshon se aktiviteti ishte pjesë e një veprimtarie më të gjerë të kontrabandës dhe po vijon hetimet për dokumentimin e plotë të rastit.

Dy 43-vjeçarët akuzohen për disa vepra penale, mes tyre "Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara", "Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës", "Kontrabanda me mallra të tjera" dhe "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë".

ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

Ndaj tyre rëndojnë gjithashtu akuzat për “Mosdeklarimin në kufi të të hollave dhe sendeve me vlerë”, “Fshehjen e të ardhurave” dhe “Pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Hetuesit po punojnë edhe për identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë të përfshirë në këtë veprimtari. Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për veprime të mëtejshme.


AKTUALITET / 20 September 2026, 10:13

Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar

AKTUALITET / 19 September 2026, 22:26

Shqipëria pret vitin e ardhshëm stërvitjen shumëkombëshe të NATO-s “Steadfast Dart 27”

AKTUALITET / 19 September 2026, 22:15

Përfundon protesta e 112-të para Kryeministrisë, protestuesit paralajmërojnë rikthimin: Nesër më shumë

AKTUALITET / 19 September 2026, 20:56

VIDEO/ Ndërtime pa leje në Borsh dhe Llaman, IKMT prish disa objekte

AKTUALITET / 19 September 2026, 20:50

Pas fjalimeve para Kryeministrisë, protestuesit marshojnë në rrugët e Tiranës

AKTUALITET / 19 September 2026, 20:34

Shkrirja e 15 bashkive, protestë para Parlamentit më 8 tetor: Të mos lejojmë deputetët të votojnë kundër vullnetit të popullit

AKTUALITET / 19 September 2026, 20:13

## Kingji në Komitetin Ushtarak të NATO-s: Shqipëria forcon angazhimin për mbrojtjen kolektive dhe mbështetjen e Ukrainës

AKTUALITET / 19 September 2026, 19:22

## Zbardhet dëshmia e 68-vjeçarit që vrau gruan në Tiranë: E godita me thikë në zemër se më gënjeu

AKTUALITET / 19 September 2026, 19:04

## Akuzohen për përvetësimin e 1143 hektarëve tokë përmes dokumenteve të falsifikuara, Gjykata lë në burg ish-drejtuesit e ASHK-së në Fier

AKTUALITET / 19 September 2026, 18:54

## Përfundon asfaltimi në segmentin Elbasan–Papër, nisin punimet për sinjalistikën horizontale

AKTUALITET / 19 September 2026, 18:36

## Shqipëria e 44-ta në nivel global në Indeksin e SDG-ve për vitin 2026, Rama: Do të vazhdojmë të ecim përpara

AKTUALITET / 19 September 2026, 18:05

## Fredi Beleri "mburr" deputetin e Agimit të Artë dhe sulmon drejtësinë greke, tërheq deklaratën pas reagimeve të forta nga PASOK

AKTUALITET / 19 September 2026, 17:43

## "Dënimet në Hagë e kanë kthyer politikën shqiptare në varrezë ambiciesh", Majko reagon për liderët e UÇK: Krimet e luftës janë betejat për pushtet pas luftës

AKTUALITET / 19 September 2026, 17:29

## Dogji mbeturinat, banori në Durrës i vë flakën lagjes 13, zjarri u afrohet banesave

AKTUALITET / 19 September 2026, 17:20

## Steka cigaresh kontrabandë me autobus nga Shqipëria drejt Greqisë, procedohet shoferi, në 'lupë' edhe doganierët shqiptarë që e lanë të kalonte

AKTUALITET / 19 September 2026, 17:00

## "Kayo"/ Blushi: Ka cenuar rëndë sigurinë kombëtare! Ron Yeffet është sot zv kryeministër, ministër i Mbrojtjes, Financave dhe Energjisë

AKTUALITET / 19 September 2026, 16:24

## Vrau me thikë bashkëshorten, zbardhet dëshmia e autorit: Kishim konflikte! Qëndronte te shtëpia e vajzës, i kërkoja të...

AKTUALITET / 19 September 2026, 15:51

## Më 8 tetor miratohet harta e re territoriale. Votat në favor të mazhorancës, PD kundër

AKTUALITET / 19 September 2026, 15:46

## Krimi në Tiranë! U vra me thikë nga bashkëshorti, del fotoja e viktimës 58-vjeçare

AKTUALITET / 19 September 2026, 15:39

## Alarm për shëndetin e fëmijëve/ Dyfishohen rastet e hipertensionit, kardiologia: Enët e gjakut po plaken para kohe

Built & Monetized by Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.